

# A përbëjnë lokucionet një mënyrë të veçantë të fjalëformimit?

Mr. Agim Spahiu

30 qershor 2003

## Përmbledhje

Autori i këtij shkrimi është ndalur në një varg çështjesh që kanë të bëjnë me kategorinë leksiko-gramatikore të lokucioneve, e në mënyrë të veçantë të fjalëformimit të tyre. Dhe e gjithë problematika është shtruar që në krye të shkrimit në formë pyetjeje, se a përbëjnë a jo lokucionet një mënyrë të veçantë të fjalëformimit. Dhe, pasi ka shtruar një varg argumentesh për këtë çështje, ai ka ardhur në përfundim se edhe lokucionet sikur çdo fjalë tjetër e leksikut, përbëjnë një mënyrë të veçantë, një sui generis të fjalëformimit, për vetë faktin se ato janë ndërtime të qëndrueshme, leksikalisht të kufizuara dhe, ajo që është më e rëndësishme, kanë barasvlera të ngjashme a identike me fjalë të vetme.

## 1 Hyrje. Fjalët dhe lokucionet. Ku dallojnë e ku përkojnë ato?

Fjalët dhe lokucionet janë njësi leksiko-gramatikore të cilat shquhen me disa karakteristika të përbashkëta e dalluese. Tipari më formal dallues i tyre është se fjalët kanë një strukturë të mbyllur, kurse lokucionet kanë një strukturë të hapur. Çdo fjalë formohet prej një morfeme leksikore të tipit të hapur a të mbyllur dhe prej një a disa morfemave gramatikore (parashtesa, prapashtesa; parashtesa e prapashtesa njëkohësisht, një a më shumë mbaresa rasore e vetore etj.), ndërsa lokucionet përbëhen prej dy a më shumë fjalësh emërtuese e shërbyese; janë grupe të caktuara fjalësh të cilat në ligjërim hyjnë a përdoren si tërësi e pandashme. Mirëpo e përbashkëta e tyre është ana funksionale, ngase si fjalët, po ashtu edhe lokucionet emërtojnë frymorë e gjësende, veçojnë tipare a cilësi të tyre, përcaktojnë sasi a shuma të caktuara, shprehin veprime, gjendje, rrethana etj. Dhe më e rëndësishmja është se të dyja këto njësi duhet t'i takojnë patjetër njërës prej pjesëve të njohura të ligjëratis: P. sh. në analizën gramatikore fjala dëshiroj dhe lokucioni kam dëshirë nuk ka se si të merren ndryshe pos si folje me kuptim sinonimik, në morfologji, ose si kallëzues të thjeshtë foljorë, në sintaksë.

## **2 Si dhe sa janë trajtuar lokucionet në Gramatikën e gjuhës shqipe, Vëllimi I, Morfologjia, hartuar nga ASHRSH-së në Tiranë, më 1995/20021? A janë konsideruar ato si një mënyrë e veçantë e fjalëformimit dhe sa kanë gjetur vendtrajtim nëpër pjesë të caktuara të ligjëratës?**

Në këtë Gramatikë mund t'i vëmë re disa luhatje, pasaktësi e inkonsekuenca lidhur me këtë çështje për vetë faktin se në kapitullin mbi fjalëformimin<sup>1</sup>, nuk bëhet fjalë për lokucionet si një mënyrë e veçantë e fjalëformimit. Po kështu, edhe kur flitet për formimin e emrave, mbiemrave, përemrave, numërorëve etj., nuk merret asnjë shembull nga lokucionet e këtyre pjesëve të ligjëratës. Kjo do të thotë se nuk njihet qenësia e tyre. Një përjashtim të vogël e kemi te foljet, meqë aty, në fillim të këtij kapitulli jepen disa shembuj lokucionesh si p. sh. :bëj ballë, bëj pallë, bëj zë, bie fli, (ma) ka ënda, marr parasysh, marr pjesë, marr vesh, ngre krye, ngre lart (= vlerësoj shumë), ngre peshë, vë re, vë dhjamë, vë mish, zë besë<sup>2</sup>, por ato nuk trajtohen në kuadër të fjalëformimit. Mirëpo, te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës kemi një gjendje krejtësisht tjetër, ngase në kapitullin për ndajfoljet, përkatësisht në nënkaptullin për formimin e tyre, bëhet fjalë gjerësisht edhe për lokucionet e kësaj pjese të ligjëratës<sup>3</sup>. Kështu veprohet edhe me lokucionet lidhëzore<sup>4</sup>, parafjalore<sup>5</sup>, pjesëzore<sup>6</sup> etj.

## **3 Cilat mund të jenë shkaqet e mospërfshirjes dhe të mostrajtimimit të lokucioneve të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës në këtë Gramatikë dhe në gramatikat të tjera të mëhershme? Si qëndron çështja në studimet e mëvonshme gjuhësore?**

Sipas mendimit tonë, mospërfshirja dhe mostrajtimi i lokucioneve të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës në këtë Gramatikë, por edhe në ato të mëhershmet mund të lidhen me dy çështje: me çështje të kriterit dhe me atë të traditës. Sa i përket çështjes së kriterit, ne mendojmë se që në fillim të këtij teksti jepet një përkufizim i përgjithshëm, i cili do të duhej të vlente për të gjitha lokucionet e pjesëve të të ligjëratës. Por kjo nuk ndodh, pasi që autorët e këtij teksti nuk e shohin të udhës që ato rregulla apo ato kritere të përfshira në atë përkufizim, të zbatohen, përlligjen a të përgjithësohen edhe te pjesët e ndryshueshme të ligjëratës. Ky moszbatim i kritereve të përgjithshme ndoshta e ka pikënisjen në faktin se lokucionet e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës ka qenë

---

<sup>1</sup>Shih veprën, f. 43-79.

<sup>2</sup>Po aty, f. 260.

<sup>3</sup>Po aty, f. 377-380.

<sup>4</sup>Po aty, f. 400-402.

<sup>5</sup>Po aty, f. 385-396.

<sup>6</sup>Po aty, f. 415.

shumë më lehtë të identifikohen nga studiuesit e saj, mu për arsye se ato shquhen me një shkallë shumë më të lartë të qëndrueshmërisë së elementeve përbërëse, veçohen shumë më lehtë në çdo ligjërim, për dallim nga ato të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës. Ndërsa çështja tjetër ka më tepër një bazë tradicionale, ngase në historinë e gjatë të gramatologjisë shqiptare shumë gjëra e shpjegime janë bartur nga autori në autor, nga një version në një version tjetër të teksteve dhe kështu pa ndryshime të mëdha u janë transmetuar gjeneratave të tëra deri në ditët e sotme. Mjafton për këtë t' u hedhesh një sy gramatikave tonë dhe shpejt do të shohësh se për lokucione të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës nuk flitet as në gramatikën e I. D. Sheperit (Gramatika e gjuhës shqipe, Sindaksa, Vlorë, 1927), as në atë të O. Myderrizit (Gramatika e Re e shqipes, Tiranë, 1944), as në atë të K. Cipos (Gramatika shqipe, Tiranë, 1949), as në atë të Sh. Demirajt (Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, dispensë, Tiranë, 1961), as në atë të S. Priftit (Sintaksa e gjuhës shqipe II, dispensë, Tiranë, 1962) etj.

Kjo gjendje mund të thuhet se ka mbizotëruar përgjithësisht edhe në studime të tjera gjuhësore deri më 1985/86. Por në këto vite shohim përpjekjen e disa studiuesve për ta shpënë përpara këtë çështje. Kështu, fjala vjen, M. Domi në vitin 1985 ka botuar një studim në numrin 1 të Studimeve filologjike me titull Disa çështje të lokucioneve, në të cilin ka sjellë të dhëna të mjaftueshme e të pakontestueshme për qenësinë e lokucioneve, sidomos të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës në gjuhën tonë. Për ta arsyetuar këtë qenësi, ai, që në fillim, ka sjellë referenca nga disa fjalorë gjuhësorë, gramatika e studime të gjuhëve të tjera. Nga këto të dhëna të ofruara është parë se gati të gjithë studiuesit pajtohen se lokucionet përbëjnë grupe fjalësh që kanë një lidhje të qëndrueshme midis tyre dhe që, si kuptimisht ashtu edhe gramatikisht, janë të barasvlershme me një fjalë të vetme, por jo identike me të (vetëm si ndërtime sinonimike); Aty është vënë në dukje edhe humbja e mëvetësisë leksikore të fjalëve përbërëse (ajo është e shkallëshkallshme), për fjalët që përdoren me kuptim të figurshëm etj. , si karakteristika të përgjithshme të frazeologjizmave, por edhe të lokucioneve. Dhe kjo ka bërë që shumë studiues, në mungesë të përcaktimit të saktë të kufirit të tyre, të mos jenë në gjendje shpeshherë t' i dallojnë ato. Kjo është një problematikë me të cilën preokupohet edhe Domi në artikull studimor (i publikuar në rubrikën Diskutime të kësaj reviste shkencore). Këto kanë qenë disa argumente që e kanë nxitur këtë studiues e shquar të nxjerrë një përfundim logjik se edhe në gjuhën tonë ka mjaft njësi të ngjashme gjuhësore të cilat i plotësojnë këto kritere a kushte edhe në kuadrin e pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës dhe të cilat s' kemi si t' i emërtojmë ndryshe pos si lokucione. Dhe ato, sipas tij duhet të përbëjnë një mënyrë të veçantë fjalëformimi, ashtu siç veprohet edhe në disa gjuhë të tjera.

Në anën tjetër, një kontribut për studimin e lokucioneve foljore e ka dhënë edhe studiuesja Zana Daci e cila në disa numra të revistës "Studime filologjike" është marrë me trajtimin dhe klasifikimin e tyre në gjuhën tonë.

## 4 A ka vërtet lokucione të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës në gjuhën tonë?

Po të merren parasysh karakteristikat e përgjithshme të lartshënuara dhe po të përliqjen ato me përpikëri, atëherë s'ka dilema se edhe në kuadrin e pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës do të kemi disa lloje lokucionesh (por jo në atë masë sa të lokucionet e pjesëve të pandryshueshme). Kështu p. sh. si lokucione emërore ka mundësi të trajtohen togfjalëshat si: lule bore, lule dhensh, lule mos prek, bar pezmi etj. (nga fusha e bimësisë); Arusha e Madhe, Arusha e vogël etj. (nga fusha e astronomisë); nusja e lalës (nga fusha e zoologjisë); molla e Adamit (nga fusha e anatomisë); Bjeshkët e Nemuna, Qafa e Thanës (nga emërtimet gjeografike); i zoti i shtëpisë, e zonja e shtëpisë (nga leksiku i përgjithshëm); vënia re, zënia besë, marrja parasysh (si ndërtime dytësore, meqë vijnë nga foljet) etj. Të gjithë këto ndërtime dhe të tjerat si këto i konsiderojmë lokucione emërore për këto arsye: Së pari, të gjithë këto ndërtime shënojnë frymorë a gjësende nga realiteti ynë objektiv, që është një prej parakushteve më themelore për njësitë gjuhësore emërtuese; Pastaj, të gjitha elementet përbërëse të tyre shprehin nocione konkrete dhe abstrakte, ashtu siç mund të shprehin vetë emrat e parmë (të thjeshtë), të prejardhur, të përbërë e të përngjitur; Pastaj, po të shikohen gramatikisht, ato të gjitha kanë vlerë dhe funksion emëror etj. , sepse janë të pandashme etj. Prandaj këto janë kriteret që na çojnë në një përfundim se këto ndërtime gjuhësore duhet t'i marrim e t'i konsiderojmë si lokucione emërore. Këto kritere, me disa përjashtime të vogla, vlejnë përgjithësisht edhe për ndërtimet shumëpjesëshe të pjesëve të tjera të ndryshueshme të ligjëratës. Këtu mund të flitet edhe për disa togfjalësha me vlerë e funksion mbiemëror, kryesisht të ardhur nga foljet, si p. sh. : i vënë re, i dalë menç, i çuar peshë, i ndarë nga jeta, i vënë në spikamë e ndonjë tjetër; pastaj për ata përemërorë si: gjë që, gjithë ç', tërë sa, ai që (kur del i barasvlershëm me përemrin kush, p. sh. : Ai që punon, fiton; > Kush punon fiton.), kushdo që, cilido që etj. ; ata numërorë që shprehin numra e sasi të caktuara, p. sh. Njëzet e një, njëqind e njëzet e një, një mijë e njëqind e njëzet e shtatë etj. ; e thyesat: një e dyta, dy të tretat, tri të katërtat etj. , dhe ata foljorë të cilët janë të shumtë që u përmenden pak më lart në këtë trajtesë. Pra, të gjitha këto togje e togfjalësha i plotësojnë kushtet a kriteret më themelore për t'i kualifikuar si ndërtime gjuhësore me emërtimin e vërtetë si lokucione gjuhësore nga pjesët e ndryshueshme të ligjëratës, emërtim ky të cilin e kemi ndeshur shumë rrallë në shkrimet dhe tekstet tona gramatikore.

## 5 Përfundim

Jo vetëm fjalët, por edhe lokucionet shprehin frymorë e jofrymorë, tipare, cilësi, sasi, veprime etj. , i takojnë patjetër njëres prej pjesëve të ligjëratës në analizën gramatikore, etj. Kurse njëra prej pikave dalluese formale është se fjalët kanë strukturë të mbyllur, kurse lokucionet të hapur. Se a shprehin nocionet me një fjalë apo më shumë fjalë, kjo nuk është shumë me rëndësi për cilindo folës të gjuhës. Me rëndësi është që te folësi i asaj gjuhe të transmetohet me përpikëri porosia e duhur. Për shqipfolësin është njësoj të thuhet: i zoti i shtëpisë apo kryefamiljari, zonja e shtëpisë apo amvisja; nusja e lalës

apo bukla; molla e Adamit apo fikthi etj. te sistemi emëror; kam dëshirë apo dëshiroj, zë besë apo besoj, bëj be apo betohem, më doli nga mendja apo s'më kujtohet, harrova etj. te sistemi foljor; i ndarë nga jeta apo i vdekur, i çuar peshë apo i lazduar, i(e) lënë pas dore apo i (e) braktisur, i vënë re apo i hetuar, i diktuar etj. te sistemi mbiemëror; 127 me numra apo njëqind e njëzet e shtatë me shkronja, 1/2 apo gjysma, 1/4 apo çereku etj. te numërorët; ai që apo kush, gjë që apo çka etj. te sistemi përemëror, e kështu me radhë.

Lokucionet kanë lidhje shumë të ngushta me fjalët e përngjitura dhe të përbëra, sepse këto në shumë raste janë formuar nga lokucionet. Të krahasohen p. sh. togjet e dikurshme, si: thash e them, farë e fis, tre mbë dhjetë, as kush, drejt për drejt, vë re, falem nderit, t'u ngjattë jeta etj; dritë dhe hije, dele dhe dash, gusht o vjeshtë etj. , të cilat sot në gjuhën e shkruar e të kodifikuar përdoren të njëfjalësuar, si: thashetheme, farefis, trembëdhjetë, askush, drejtpërdrejtë, vërej, falemnderit, tungjatjeta, dritëhije, gushtovjeshtë. Shumë nga këto fjalë të përngjitura e të përbëra, para se të bashkoheshin, mendohet të kenë pasur disa nuanca të tjera kuptimore, si p. sh. fjala e përbërë mikëpritje nuk do të thotë thjeshtë "pritje e mikut", por *pritje dhe trajtimi i mikut me bujari, me përzemërsi dhe nderim të veçantë*<sup>7</sup>. Edhe te lokucionet mund të vihen re këto ndryshime kuptimore. Lokucioni foljor s'ma merr mendja dallohet kuptimisht dhe gramatikisht nga togfjalëshi m'i mori paratë, sepse elementet përbërëse të lokucionit s'ma merr mendja e kanë humbur aq shumë mëvetësinë kuptimore sa që të gjitha së bashku sajojnë kuptimin kategorial të foljes sinonime s'besoj, nuk bindem dot etj. , kurse elementet përbërëse te togfjalëshi m'i mori paratë janë krejtësisht të mëvetësishme, sepse secila fjalë bart në vete kuptimin e plotë leksikor e të drejtpërdrejtë. Prandaj këtë të fundit e konsiderojmë si një togfjalësh të lirë a sintaksor. Edhe në analizën gramatikore togfjalëshi i parë apo lokucioni s'ma merr mendja merret si një folje e veçantë apo si një kallëzues i thjeshtë foljor, kurse togfjalëshi i lirë *m'i mori paratë* duhet të zbërthehet në kallëzues + kundrinë e drejtë.

Këto janë disa të dhëna që na çojnë kah përfundimi se, sikur njësitë leksikore njëfjalëshe (qofshin ato fjalë të parme, të prejardhura, të përbëra, të përngjitura etj.), po ashtu edhe ato disafjalëshe, siç janë lokucionet, janë njësi gjuhësore që mund të radhiten në të njëjtën shkallë të sistemit gjuhësor. Prandaj është e paarsyeshme që të merremi vetëm me analizën fjalëformuese të fjalëve dhe të mohohen krejtësisht lokucionet nga ky aspekt, ngase, sikundër që mund të zbërthehen e analizohen morfematisht fjalët e veçanta, po ashtu mund zbërthehen e analizohen nga ana strukturore edhe lokucionet e të gjitha pjesëve të ligjëratës në elemente përbërëse të tyre. Pra, derisa ne kemi mundësi, po e zëmë, t'i zbërthejmë foljet e tipit: përpunoj, përgënjeshtroj, përjashtoj etj. , në parashtesën e përbashkët -për; në morfemat rrënjore: punë/gënjeshtër/jashtë/; në prapashtesën foljore o e në mbaresën vetore -j, atëherë pse të mos e bëjmë këtë edhe për lokucionet emërore të tipit, si: *i zoti i shtëpisë/e zonja e shtëpisë, molla e Adamit, nusja e lalës* etj. në përbërësit e tyre: emër në rasën emërore+emër në rasën gjinore, ose për ndonjë tip tjetër të lokucioneve të pjesëve të tjera të ligjëratës, qofshin të ndryshueshme ose të pandryshueshme?

<sup>7</sup>Shih Gramatikën e lartpërmendur, f. 71

Këto kujtojmë janë disa të dhëna të mjaftueshme për të ardhur te përfundimi qendror se edhe lokucionet përbëjnë një mënyrë të veçantë të fjalëformimit, ngase aty ku bëhet fjalë për mënyrat e njohura të fjalëformimit të emrave, mbiemrave, përemrave, numërorëve dhe foljeve, aty ka mundësi të flitet edhe për strukturën fjalëformuese të lokucioneve përkatëse. Porse e gjithë kjo është e lidhur ngushtë dhe e kushtëzuar, në radhë të parë, me njohjen e qenësisë së lokucioneve të pjesëve të ndryshueshme të ligjëratës nga ana e gramatikanëve dhe studiuesve tanë në të ardhmen.